



Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohen të gjithë fermerët e Komunës së Prishtinës se mund të aplikojnë për përkrahje në lëmin e prodhimit të organikëve bimë mjekuese “Goji berry”:

Kriteret :

- Përkrahen fermerët për mbjellje të sipërfaqes prej 0,25-0,50 ha;
- Përfituesi duhet të jetë banorë dhe të ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës;
- Fermerët janë të obliguar që ta bëjnë vet furnizimin me fidanë, si dhe mbjelljen e tyre në sipërfaqen e planifikuar;
- Sipërfaqet e planifikuara për mbjellje më së paku tri vite nuk duhet të kenë qenë të mbjella me kultura konvencionale;
- Rimbursimi i mjeteve nga ana e Komunës për fermerët do të bëhet pas konstatimit se janë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara, si dhe varësisht nga numri i fidanëve të mbjellë ;
- Fermerët duhet të furnizohen me fidanë nga entiteti i licencuar për prodhimin dhe tregtimin e bimëve aromatike-mjekuese “Goji Berry” (hibrid);
- Fermerët e zgjedhur janë të obliguar që të bëjnë analizën e tokës - parcelës që do e mbjellin me “Goji Berry” dhe nëse këto analiza tregojnë se ajo parcelë nuk i plotëson kriteret për kultivimin e kësaj kulture, atëherë përfituesi/ja do të refuzohet;
- Duhet të investojnë në vendosjen e sistemit të ujitjes pikë – pikë;
- Të gjitha transaksionet - pagesat duhet të realizohen nëpërmes sistemit bankar.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirrollogarin bankare;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme, me afat deri në një vit;
- Kopja e planit;
- Licenca e entitetit ku është furnizimi me fidanë;
- Fatura;
- Certifikata e origjinës së fidanëve;
- Certifikata fito-sanitare;
- Konfirmimi i transaksionit bankar.

Data e aplikimit, prej 30.03. deri 12.04.2017.